



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1022/2 Prot.

Rrëshen me, 26 . 03 . 2024

V E N D I M

Nr. 27 datë 18.03.2024

PËR

“MIRATIMIN E HAPJES, SË RRUGËS KËMBËSORE DHE KTHIMIN E SAJ NË RRUGË AUTOMOBILISTIKE, E CILA FILLON NGA AKSI I RRUGËS "KATUNDI I VJETËR 03200007" DERI BANESËN E Z. GJERGJ PRENGA, FSHATI KATUNDI I VJETËR, NJËSIA ADMINISTRATIVE RUBIK, 4603”, BASHKIA MIRDITË.

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 3, pika 11, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (të ndryshuar), neni 6, gërma “i”, të VKM.nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, (të ndryshuar), ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”, kërkesës nr. 1151 prot, datë 18.04.2023 adresuar bashkisë Mirditë dhe projekt –vendimin e paraqitur nga kryetari i bashkisë (Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit), Raporti i studimit teknik-ekonomik, nr. 1022 datë 08.03.2024, nga sektori i pyjeve dhe planimetria sh. 1:3 000. Rilevimi topografik sh. 1:1 000 nga drejtoria e planifikimit, zhvillimit të territorit dhe strehimit, së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga kryetari i bashkisë, pas diskutimeve në mbledhjen e këshillit bashkiak;

V E N D O S I:

1. Miratimin e hapjes së rrugës këmbësore dhe kthimin e saj në rrugë automobilistikë që fillon nga aksi i rrugës "Katundi i Vjetër 03200007" deri banesën e Z. Gjergj PRENGA, fshati Katundi i Vjetër, njësia administrative Rubik, 4603, Bashkia Mirditë.
 - Segmenti i rrugës ka një gjatësi totale $L = 452$ ml, gjërësi kaluese 3.50 ml, me sipërfaqe totale prej $1\ 582\ m^2$ (0.1582 ha) dhe shtrihet në pasuritë me nr. pas. 422 (n/ngastra pyjore nr. 71a, ekonomia pyjore / kullosore Luginat e Rubikut), Zona Kadastrale nr. 2125, Sh 1: 1, 3 000.

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

2. Bashkëlidhur, planimetria Sh. 1 : 1, 3 000, Rilevimi topografik Sh. 1 : 1 000, projekti teknik i plotë, raporti tekniko – ekonomik i fondit pyjor/kullosor, me nr. 1022 prot, datë 08.03.2024, si dhe informacion kadastral mbi pasuritë që preket nga ndërtimi i rrugës, pjesë përbërse e këtij vendimi.
3. Punimet dhe mirëmbajtja e rrugës automobilistike, do të kryhen nga komuniteti i zones.
4. Pas ndërtimit, rruga do të jetë në përdorim të të gjithë komunitetit dhe pronë e bashkisë Mirditë dhe në inventarin e Agjencisë së Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë.
5. Për ndjekje e zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet kryetari i bashkisë, (drejtoria e planifikimit, zhvillimit të territorit, APPM-Mirditë dhe njësia administrative Rubik).

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICAË

